



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 82 Prot.

Tiranë, më dt. 20.02.2018

VENDIM

Nr.72, dt. 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 20.02.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Kaskada e HEC-eve te Hotolishtit” (“HEC Rrepshe”, “HEC Hotolisht Çota”, “HEC Kokreve”, “HEC Hotolisht Qender”), Librazhd, me subjekt aplikues “HEC HOTOLISHT” sh.p.k.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Banesa e Gani Allushit, fshati Zdrajsh, komuna Orenjë, Librazhd”, Qarku Elbasan.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të **mbikëqyren** sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR

Mirela Kumburo Furxhi

SEKRETARI I KKR

Arta Dollani